

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6978  
E enjte, 24 gusht 2023  
Çmimi 0.40

Rama pretendon se nafta e zbuluar në Shqipëri e ka cilësinë e naftës saudite **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## DELAWIE: ZYRTARËT NË UASHINGTON NUK PO SHOHIN BASHKËPUNIM TË DUHUR NGA QEVERIA E KOSOVËS **FAQE 4-5**



Ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, thotë se marrëdhëniet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës janë të forta, por pranon se veprimet e fundit të qeverisë në Prishtinë i

kanë vënë në vështirësi këto lidhje. "Mendoj se zyrtarët në Uashington nuk po shohin bashkëpunimin e duhur nga Qeveria e Kosovës dhe nga këndvështrimi i tyre ata po përgjigjen në mënyrë të përshtatshme", ka deklaruar

Delawie për "Zërin e Amerikës". Ai ka thënë se Kosova duhet ta shfrytëzojë mundësinë dhe ta hartojë planin e vet për Asociacionin e Komunave Serbe, i cili duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës

### SHTYHET PËR DY MUAJ PROCESI I REGJISTRIMIT TË POPULLSISË NË KOSOVË **FAQE 3**



### VONESA E SHPËRNDARJES SË TEKSTEVE MËSIMORE NGA MASHTI PAMUNDËSON FILLIMIN E MBARË TË VITIT SHKOLLOR **FAQE 5**



### AKTUALE



QEVERIA GJERMANE PAJTOHET T'I LEHTËSOJË PROCEDURAT PËR MARRJE TË SHTETËSISË **F. 2**

PARAQITET RASTI I PARË ME ETHE TË MINJVE NË KOSOVË **F. 3**

INAUGUROHET NË PRISHTINË "MURI I NDERIT" **F. 7**

### EKONOMI



FALJA E 100 EUROVE TË TATIMIT NË PRONË, ASOCIACIONI I KOMUNAVE PRITET TA DËRGOJË LIGJIN NË KUSHTETUESE **F. 8**

SHKARKOHET BUJAR EJUPI NGA POZITA E DREJTORIT TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL **F. 9**

### SPORT



DAJA DHE GRIPSHI: BALLKANI DO TA PËRFAQËSOJNË NË MËNYRËN MË TË MIRË KOSOVËN **F. 10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Qeveria gjermane pajtohet t'i lehtësojë procedurat për marrje të shtetësisë

**BERLIN, 23 GUSHT** - Kabineti gjerman i ka miratuar më 23 gusht planet për ta lehtësuar rrugën drejt shtetësisë për emigrantët dhe për të lejuar më shumë njerëz të kenë nënshpëtim të dyfishtë. Sipas rregullave të reja të propozuara, të cilat ende duhet të miratohen nga parlamenti, natyralizimi në Gjermani do të ishte i mundur pas pesë vjetësh në vend të tetë vjetëve sa është tani. Ata që janë veçanërisht të integruar mirë dhe kanë aftësi shumë të mira të gjuhës gjermane do të mund ta marrin nënshpëtimin pas vetëm tre vjetësh.

Qytetarët e rinj potencial do të duhet të tregojnë se nuk janë të



varur nga ndihmat sociale të shtetit, megjithëse do të ketë përjashtime nga ky kusht.

Projektligji do t'ua hapë gjithashtu derën më shumë njerëzve që të mbajnë

nënshpëtim të dyfishtë, përfshirë ata nga komuniteti i madh turk i Gjermanisë.

Rruga drejt shtetësisë ka mbetur e vështirë për shumë emigrantë nga Turqia dhe vende të tjera që erdhën në Gjermani si të ashtuquajtur "punëtorë mysafirë" në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë.

E drejta për shtetësi të dyfishtë në përgjithësi është aktualisht e kufizuar për qytetarët e BE-së dhe zviceranëve, megjithëse janë bërë disa përjashtime.

Rishikimi i legjislacionit ishte një premtime kryesor i bërë nga qeveria e koalicionit të udhëhequr nga qendra e majtë e kancelarit Olaf Scholz kur erdhi

në pushtet në fund të vitit 2021. Vendi me ekonominë më të madhe në Evropë po përpiqet të tërheqë punëtorë të huaj për t'i plotësuar mungesat akute të fuqisë punëtore dhe dëshiron ta bëjë veten një destinacion më tërheqës.

Ligji i ri pasqyron "shoqërinë e larmishme" të Gjermanisë, tha në një konferencë shtypi ministrja e Brendshme, Nancy Faeser.

Gjermania ishte në një "konkurrencë globale për mendjet më të mira" dhe do ta përmirësonte ofertën e saj për punëtorët potencial duke ofruar një rrugë të qartë drejt shtetësisë, tha Faeser.

## Rreth 100 mijë njerëz evakuohen në Pakistan shkaku i përmbytjeve

**PUNJAB, 23 GUSHT** - Shërbimet e emergjencës në Pakistan njoftuan më 23 gusht se rreth 100 mijë njerëz janë evakuuar nga fshatrat e përmbytura në provincën Punjab. Disa qindra fshatra dhe mijëra hektarë tokë bujqësore në provincën qendrore u përmbytën kur lumi Sutlej doli nga shtrati i tij të dielën.

Shërbimet e urgjencës kanë punuar për evakuimin e banorëve dhe bagëtive në zonat më të rezikuara. "Ne kemi shpëtuar 100 000 njerëz dhe i kemi transferuar në vende më të sigurta", tha zëdhënësi i

shërbimeve të urgjencës në Punjab, Farooq Ahmad, për agjencinë e lajmeve AFP.

Kreu i qeverisjes në Punjab, Mohsin Naqvi, tha se reshjet e dendura të shiut i kishin shtyrë autoritetet në Indi të lëshonin ujën e tepërt të rezervuarit në lumin Sutlej, duke shkaktuar përmbytje në anën pakistaneze të kufirit.

Zyrtarët në anën indiane nuk u janë përgjigjur pyetjeve të bëra nga AFP lidhur me këto akuza.

Agjencia e menaxhimit të fatkeqësive në Punjab paralajmëroi se shirat e parashikuar mund ta

përkeqësojnë gjendjen me përmbytjet gjatë ditëve në vijim. Pakistani është ende duke punuar në rikuperimin nga përmbytjet shkatërruese që vërshuan gati një të tretën e vendit në vitin 2022, duke prekur më shumë se 33 milionë njerëz.

Për këtë fatkeqësi faji i është hedhur ndryshimeve klimatike, teksa qindra mijëra persona kanë mbetur pa shtëpi dhe autoritetet pakistaneze kanë vlerësuar se dëmet e shkaktuara nga vërshimet arrijnë në vlerën e të paktën 10 miliardë dollarësh.



## Japonia nis përgatitjet përfundimtare për shkarkimin e ujit të kontaminuar në Paqësor

**TOKIO, 23 GUSHT** - Përgatitjet përfundimtare për shkarkimin e ujërave nga termocentrali i dëmtuar i Fukushima në Japoni filluan më 23 gusht, një ditë përpara derdhjes së planifikuar në Oqeanin Paqësor.

Tokio kishte njoftuar një ditë më parë se operacioni i zbrazjes së ujërave në Paqësor do të fillonte më 24 gusht. Ky njoftim shkaktoi reagim të ashpër nga Kina dhe kufizime të pjesshme të importit të ushqimeve të detit nga Japonia në Hong Kong dhe Makau.

Operatori i uzinës, TEPCO, tha më 22 gusht se kishte holluar një metër kub ujëra të zeza me rreth 1.200 metra kub ujë deti dhe e kishte kaluar në një tubacion prej ku mund të zbrazet në Paqësor.

Procesi do të testohet fillimisht përmes kësaj sasie fillestare dhe më pas, duke filluar nga 24 gushti, do të lëshohet në det së bashku me më shumë ujë të holluar, thuhet në një deklaratë të



TEPCO-s.

Centrali i energjisë bërthamore Fukushima-Daiichi u rrëzua nga një tërmet masiv dhe cunami që vranë rreth 18 000 njerëz në mars të vitit 2011, kur një tre nga

reaktorët e centralit u shkri.

TEPCO ka mbledhur 1.34 milionë metra kub ujë që nga atëherë, që u përdorën për t'i ftohur reaktorët ende shumë radioaktivë.

Një sistem i veçantë ka filtruar të

gjitha nuklidet radioaktive përveç tritiumit, nivelet e të cilit do të jenë brenda kufijve të sigurt, sipas TEPCO-s.

Zbrazja e këtyre ujërave në Paqësor është miratuar nga

mbikëqyrësi bërthamor i OKB-së, që tha se do të ketë personel në terren më 24 gusht për ta mbikëqyruar procesin, i cili do të marrë disa dekada kohë për t'u përfunduar.

Kina e kishte akuzuar edhe në të kaluarën Japoninë për trajtimin e oqeanit si një "kanalizim", duke ndaluar importet e ushqimeve nga dhjetë prej 47 prefekturave të Japonisë edhe para këtij procesi.

Kina thirri më 22 gusht ambasadorin e Japonisë "për të bërë përfaqësime solemne", ndërsa Hong Kongu dhe Makau, të dyja territore kineze, njoftuan ndalimin e importeve të "produkteve ujore" nga të njëjtat dhjetë rajone japoneze.

Analistët thanë se përderisa Kina mund të ketë shqetësime të vërteta për sigurinë, reagimi i saj i ashpër është gjithashtu të paktën pjesërisht i motivuar nga rivaliteti ekonomik dhe marrëdhëniet e ftohta me Japoninë.

## Vonesa e shpërndarjes së teksteve mësimore nga MASHTI pamundëson fillimin e mbarë të vitit shkollor

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kolegjiumi i Drejtorëve Komunalë të Arsimit me shqetësim ka marrë lajmin e Ministrisë së Arsimit për çështjen e furnizimit me libra shkollorë. Për Drejtoritë Komunale të Arsimit është me rëndësi që mësimi të fillojë pa vonesa dhe viti i ri shkollor t'i gjejë nxënësit me libra. "Ne jemi të bindur që propozim-vendimi i MASHTI-it do të krijojë vonesa dhe humbje efektive të mësimi. Ministria e Arsimit nuk i ka njoftuar komunat për propozimet e reja dhe ato nuk kanë pasur paraprakisht asnjë njoftim zyrtar nga ana e Ministrisë. Gjithsesi, si gjithmonë, komunat janë të gatshme ta ndihmojnë ministrinë për shpërndarjen e teksteve shkollorë. Për ne është e domosdoshme që Ministria e Arsimit t'i sigurojë sa më parë librat shkollorë, që mësimi të

fillojë në kohë, e që humbjet e orëve të mos përsëriten sikur vitin e kaluar. Në të kundërtën, barrën e vonesave do ta bartin nxënësit në mësimnxënie e prindërit në financim të librave", është thënë në reagimin e Kolegjiumit të Drejtorëve Komunalë të Arsimit.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, e ka fajësuar Ministrinë e Arsimit për dështimin e marrëveshjes për sigurimin e librave për nxënësit. Jasharaj e ka quajtur ide të gabuar që prindërit të rimbursohen për blerjen e librave të nxënësve. Në këtë kontekst, ai ka thënë se nxënësit do të mbesin në mëshirën e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci dhe të ministrit të Financave, Hekuran Murati, duke thënë se familje të shumta janë në gjendje të rëndë ekonomike. Sipas Jasharajt, jo vetëm nxënësit,

por edhe mësimdhënësit do të hasin në vështirësi në fillim të vitit shkollor për shkak të mungesës së librave. Jasharaj e ka akuzuar Nagavcin edhe për mungesë të bashkëpunimit me SBASHK-un, duke thënë se ajo është duke vazhduar të mbajë inat që nga greva e kaluar e mësimdhënësve.

Dy ditë më parë Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) ka njoftuar se nuk ka arritur marrëveshje me shtëpitë botuese lidhur me furnizimin me libra për nxënësit dhe mësimi do të fillojë për dhjetë ditë.

Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, në një konferencë për medie ka theksuar të hënën se janë duke e shqyrtuar mundësinë që transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollorë të kalojë në llogaritë e prindërve. Por nuk dihet se kur do t'u dalin paratë prindërve për t'ua blerë librat fëmijëve të tyre. Për t'i përfituar këto para për

libra, prindërit duhet të aplikojnë në e-Kosova. "Sivjet jemi duke e shqyrtuar mundësinë që transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollorë sipas obligimit ligjor të MASHTI-t të bëhet në llogaritë e prindërve dhe të njëjtët t'i blejnë tekstet për fëmijët e tyre. Shumë shpejt brenda dy-tri ditëve do të vendoset për këtë rrugë që po e shqyrtojmë. Paralelisht kemi përgatitur edhe platformën për aplikim në platformën e-Kosova me të gjitha detajet e tjera dhe kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë që në njërin anë të kemi tekste cilësore për fëmijët dhe kujdes për buxhetin e shtetit", ka thënë Nagavci.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë kritikuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Qeverinë e Kosovës lidhur me planin e ri të shpërndarjes së teksteve

shkollorë për fëmijët.

LDK-ja ka kërkuar dorëheqjen e ministres Arbërie Nagavci shkak i asaj që e ka cilësuar si "keqmenaxhim i vitit shkollor", ndërsa AAK-ja ka kërkuar rrezimin e Qeverisë së Kosovës. Ndërkaq drejtorët e arsimit nga radhët e PDK-së në nivel komunal në një konferencë për medie kanë shprehur pakënaqësinë lidhur me propozimin e fundit të ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, rreth furnizimeve me tekste shkollorë për nxënës.

Besianë Musmurati, drejtoreshë e Arsimit në komunën e Prishtinës, ka thënë se "çdo ditë e më shumë po shohim që qeveria dhe Ministria e Arsimit janë të paafta të çojnë përpara çfarëdolloj politike arsimore". Sipas saj, propozimi i ri i kësaj ministrie për rimbursimin e prindërve për blerjen e librave është shembulli i fundit dhe më i freskët i keqqeverisjes në arsim ashtu si në sektorët e tjerë.

## Paraqitet rasti i parë me ethe të minjve në Kosovë



PRISHTINË, 23 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se është paraqitur rasti i parë sivjet me ethe të minjve. Ky institut u ka bërë thirrje prindërve të kenë kujdes me fëmijët e tyre. Përmes një njoftimi, IKShPK-ja ka treguar burimet e infeksionit. "Mos përdorni fruta mali të palara sepse mund të sëmuren nga ethet e minjve! Duke qenë se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike përcjell situatën epidemiologjike me ethet e minjve, për çdo vit paraqiten raste sporadike, të cilat në Kosovë janë të përhapura, në rajonin e

Dukagjinit, rajonin e Karadakut dhe rajonin e Shalës, varësisht nga shumimi i minjve. Në laboratorët e mikrobiologjisë diagnostikua rastin e parë sivjet me ethe të minjve! Burimi i infeksionit janë minjtë. Sëmundja përhapet me ushqim, me aerosole dhe me kontakt. Rastet me ethe hemorragjike me sindromën renale sporadike janë të palidhura mes veti dhe nuk ka ndonjë shpërthim epidemik mes tyre, por pakujdesi gjatë ruajtjes së ushqimit dhe konsumimi i manave të palara mund të shkaktojë sëmundje vdekjeprurëse", ka njoftuar IKShPK-ja.



## Delawie: Zyrtarët në Uashington nuk po shohin bashkëpunim të duhur nga Qeveria e Kosovës

Ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, thotë se marrëdhëniet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës janë të forta, por pranon se veprimet e fundit të qeverisë në Prishtinë i kanë vënë në vështirësi këto lidhje. “Mendoj se zyrtarët në Uashington nuk po shohin bashkëpunimin e duhur nga Qeveria e Kosovës dhe nga këndvështrimi i tyre ata po përgjigjen në mënyrë të përshtatshme”, ka deklaruar Delawie për “Zërin e Amerikës”. Ai ka thënë se Kosova duhet ta shfrytëzojë mundësinë dhe ta hartojë planin e vet për Asociacionin e Komunave Serbe, i cili duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës

PRISHTINË, 23 GUSHT - Ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, thotë se marrëdhëniet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës janë të forta, por pranon se veprimet e fundit të qeverisë në Prishtinë i kanë vënë në vështirësi këto lidhje. Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, ambasadori Delawie u shpreh kritik edhe ndaj qasjes së Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian ndaj Serbisë. Sipas tij, Kosova do të ishte më e gatshme të dëgjonte këshillat e Uashingtonit dhe Brukselit nëse ato do t'i përgjigjeshin më

seriozisht kërcënimit që qeveria serbe paraqet ndaj Kosovës dhe demokracisë në rajon. Por ambasadori thekson se Kosova duhet t'i përmbushë detyrimet për një shoqëri shumëtnike, integrimin e serbëve në vend dhe krijimin e asociacionit. “Mendoj se mosmarrëveshja më e rëndësishme ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara lidhet me zgjedhjet për kryetarët e komunave në katër komunat në pjesën veriore të Kosovës, me shumicë serbe, për të cilat Kosova, në njëfarë forme, shpërfilli Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian... ngaqë qeveria nuk

e mori parasysh këshillën e ShBA-së për të mos i dërguar me forcë në zyrat komunale kryebashkiakët. Si përfundim, ndodhën trazira në maj, të cilat u udhëhoqën nga serbët e Kosovës, të cilët janë nën ndikimin e Beogradit. Nuk mund të harrojmë që serbët e Kosovës, sidomos në veri, janë nën ndikimin e Beogradit. Ata nuk janë aktorë të pavarur. Qeveria në një mënyrë e përsheptoi rrjedhën e ngjarjeve, duke u përpjekur t'i vendosë kryetarët e zgjedhur duke përdorur forcën. Në trazirat që pasuan dhjetëra paqeruajtës të KFOR-it u lënduan. Mendoj që bojkotimi i

zgjedhjeve nga serbët e Kosovës, protestat kundër rezultatit të tyre, dhe lëndimi i këtyre paqeruajtësve, ishin me të vërtetë sjellje që nuk mund të mbrohen e që u pasuan me arrestimin e disa policëve të Kosovës, brenda territorit të Kosovës, nga qeveria serbe. Ishte tejet provokuese. Pa dashur të justifikoj kontributin e saj te dhuna, mendoj se Kosova mund të ishte më e gatshme t'i dëgjojë këshillat e Perëndimit, të Shteteve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian, po të shihet se BE-ja dhe ShBA-ja po i përgjigjeshin më me seriozitet kërcënimit që qeveria serbe paraqet ndaj Kosovës, ndaj qytetarëve të Serbisë dhe ndaj rajonit”, ka theksuar Delawie.

Ai ka thënë se, fatkeqësisht, Shtetet e Bashkuara dhe evropianët nuk po i përgjigjen si duhet dobësimit të demokracisë në Serbi. “Duket se po i ofrojmë stimujt e gabuar. Ndoshta ky është rezultat i përqendrimit për të ardhmen e afërt te konflikti në mes të Rusisë dhe Ukrainës, por nuk mendoj se do t'i shërbejë ndokujt në të

ardhmen afatgjatë. Autoritarizmi në rritje në Serbi dhe dobësimi i demokracisë e lirisë së shtypit paraqet kërcënimin më të madh ndaj Ballkanit perëndimor aktualisht. Është e qartë që Serbia po e shpërfill Perëndimin vitet e fundit. Dhe, sa duket, në Perëndimi, kolektivisht, nuk duket se kemi reaguar si duhet. Dhe, mbase, Kosova konsideron se nëse kjo qasje po funksionon për Serbinë, mbase mund të funksionojë edhe për të. Por unë jam i sigurt që Kosovës nuk do t'i shërbente një strategji e tillë. Mendoj se Kosova duhet të angazhohet më shumë të bashkëpunojë me miqtë e saj, me vendet mike të saj që nga vitet '90, që e kanë mbështetur pavarësinë dhe zhvillimin e saj”, ka pohuar ai.

Ish-ambasadori amerikan ka theksuar se si duket Qeveria e Kosovës ka vendosur se nuk dëshiron ta vazhdojë për momentin çështjen e integritetit të serbëve të Kosovës, përfshirë, jo vetëm, çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Kjo duket që është arsyeja që

## Escobari dhe Lajçaku diskutojnë për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINE, 23 GUSHT - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajçak, ka bërë me dije se gjatë takimit me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, kanë diskutuar “në thellësi” për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Bashkë me ekipet tona ne e kaluam ditën e djeshme në një diskutim të thellë për dialogun, gjendjen aktuale dhe rrugën përpara, edhe për çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor”, ka shkruar Lajçak në “Twitter” për takimin e tyre të 22 gushtit në Bruksel. BE-ja ndërmjetëson prej më shumë se dhjetë vjetësh në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas tensionimit të situatës në veri të Kosovës në fund të majit, BE-ja ka kërkuar vazhdimisht shtensionimin e menjëhershëm të situatës dhe kthimin në dialog.

Bashkë me konstatimin se Qeveria e Kosovës i ka injoruar kërkesat e saj, BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës në fund të qershorit, në formë të pezullimit të përkohshëm të punës për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Po ashtu, prania e Kosovës në organizimet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale janë pezulluar. Në tentimin për t'i ulur tensionet në veri, Lajçaku dhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, arritën marrëveshje për shtensionim të situatës në veri më 10 korrik, në Bratisllavë. Përveç hapave konkretë që kanë të bëjnë me tërheqjen e policisë nga dhe rreth ndërtesave komunale në veri dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja, BE-ja theksoi edhe rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve të dala nga dialogu. Shtensionimi i situatës në veri dhe kthimi në dialog janë




kërkesa edhe të shteteve perëndimore ndaj Kosovës. Ambasadori i ShBA-së në

Kosovë, Jeffrey Hovenier, gjatë një bisede me gazetarët në Prishtinë, më 16 gusht, tha se

kërkesat e vendit të tij ndaj Qeverisë së Kosovës nuk kanë të bëjnë me presion.

## Rama pretendon se nafta e zbuluar në Shqipëri e ka cilësinë e naftës saudite

TIRANË, 23 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë të mërkurën se nafta e zbuluar në Shqipëri është “e një cilësie shumë të lartë, e ngjashme me atë premium të Arabisë Saudite”. Në një konferencë për medie më 23 gusht, Rama tha se shpimi ka arritur në 6 000 metra në thellësi të tokës pas një pune 10-vjeçare në zonën e Shpiragut, rreth pesë kilometra larg qytetit qendror të Shqipërisë, Berat. “Rezerva është aty, në 6002 km në thellësi të tokës. Është prekur rezerva pas një eksplorimi shumë të vështirë dhe një investimi masiv të bërë për shkak të thyerjes së përsëritur të sondave si rezultat i formacionit gjeologjik”, tha Rama. Kryeministri theksoi se ende nuk është ndeshur në ujë, çka do të thotë se, sipas tij, sasia e naftës do të jetë e madhe. “Sipas analizave të bëra në Holandë nga kompania ‘Shell’, është naftë e së njëjtës cilësie të naftës premium të Arabisë Saudite”, theksoi ai.



Kërkimet për naftë në zonën e Shpiragut në Berat po kryhen nga kompania “Shell”. Pritet të

hapen mbi 15 puse. Kryeministri shqiptar tha se paralelisht do të bëhen

kërkime për naftë edhe në zonën e Dumresë në Divjakë. Kryeministri Rama parashikoi

se ky zbulim do të sjellë një “përfitim të madh ekonomik dhe financiar”, dhe se investimi i përgjithshëm në rezervat e naftës do të shkojë në shtatë miliardë euro. “Kjo pasuri do të ketë ndikim te pensionet, sistemin e arsimit, shëndetësisë, mirëqenien e fëmijëve tanë”, nënvizoi Rama.

Ai bëri me dije se nga fundi i tetorit dhe në fund të dhjetorit do të ketë një rezultat publik nga vetë kompania “Shell” në lidhje me krijimin e infrastrukturës për nxjerrjen e naftës. Në momentin që do të nisë prodhimi do të ketë mbi 5 mijë të punësuar, sipas tij. Edhe pse e pasur me rezerva naftë, Shqipëria nuk ka industri të përpunimit të saj. Nafta që nxirret përpunohet jashtë Shqipërisë dhe më pas importohet dhe shpërndahet në tregun vendas, me një çmim që rezulton të jetë më i shtrenjti në rajon. Aktualisht një litër naftë kushton 190 lekë ose 1.90 euro.

ka ngjallur pakënaqësinë dhe reagimin e Uashingtonit. Bashkëpunimi duhet të jetë i dyanshëm. Mendoj se zyrtarët në Uashington nuk po shohin bashkëpunimin e duhur nga Qeveria e Kosovës dhe nga këndvështrimi i tyre, ata po përgjigjen në mënyrë të përshtatshme”, ka deklaruar Delawie.

Cila është rrugëdalja për hartuesit e politikave në Kosovë dhe në Uashington nga kjo situatë?, është përgjigjur Delawie: “Mënyra për të dalë nga kjo situatë është që të kthehemi tek ajo që Kosova ka dashur të jetë në fillim, një demokraci multietnike në Ballkanin Perëndimor; të gjejë rrugët se si të ecë drejt një të

ardhmeje të tillë, me një gjithëpërfshirje më të mirë të serbëve të Kosovës dhe pakicave të tjera në vend. Ajo që ka mbetur pezull që nga viti 2013 është asociacioni. Mendoj se është i rëndësishëm. Kosova duhet ta shfrytëzojë mundësinë dhe ta hartojë planin e vet për këtë asociacion e që të jetë në përputhje me

Kushtetutën e Kosovës. Si diplomat me përvojë 35-vjeçare në fushën e negociatave, e di që po ta kesh mundësinë që ta bësh palën tjetër të punojë në bazë të një plani paraqitur prej teje. Ky është një plus. Nëse pala e kundërt e përpilon planin, atëherë pikënisja është ai plan. Dhe nëse Qeveria e Kosovës

nuk e ka hartuar një projekt-plan për asociacionin, atëherë është në pozitë disavantazhi. Duhet një përfshirje më e mirë e serbëve, jo vetëm me asociacionin, por të gjendet mënyra se si ata ta ndiejnë se Kosova është shteti i tyre. Dhe duhet të ulen tensionet. Serbët janë pjesë integrale e vendit ashtu si komunitetet e tjera”.

## Komuna e Mitrovicës dhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare koordinohen për bashkëpunim

MITROVICË, 23 GUSHT - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me drejtoreshën për Buxhet dhe Financa, Igballe Islami dhe drejtorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Elvis Feka, kanë pritur në takim

drejtoreshën ekzekutive të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani dhe asistenten ekzekutive Elena Elshani. Ky takim ishte i karakterit koordinues për punën e Odës Ekonomike Gjermane, si dhe për

mundësitë e bashkëpunimit potencial ndërmjet dy institucioneve. Kryetari Hamza e falënderoi drejtoreshën Hasani për vizitën dhe shprehu gatishmërinë e bashkëpunimit ndërinstytucional.



## Në Kamenicë organizohet debat për promovimin e trashëgimisë kulturore



KAMENICË, 23 GUSHT - Organizata joqeveritare Dardanapress, në kuadër të projektit "Promovimi i vlerave të diversitetit të trashëgimisë kulturore dhe historike", ka organizuar debatin me temë "Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe ndikimi në zhvillimin ekonomik lokal". Qëllimi i debatit ishte promovimi i vlerave kulturore historike, vendndodhja e objekteve të trashëgimisë kulturore në komunën e Kamenicës, rritja e vetëdijesimit të qytetarëve të komunës së Kamenicës për rëndësinë e trashëgimisë kulturore. Rekomandime dhe konkluzione të dala nga debati janë: mirëmbajta e monumenteve, përcaktimi i

objektit dhe hapja e një muzeu, shenjzimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, promovimi i resurseve kulturore, konservimi i artefakteve, punësimi i punëtorëve për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore historike, identifikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore të cilat mund të vizitohen nga personat me nevoja të veçanta, dhënia në shfrytëzim të objekteve për hapjen e bujtinave, rritja e numrit të vizitorëve dhe turizmit me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal etj. Projekti "Promovimi i vlerave të diversitetit të trashëgimisë kulturore dhe historike" është financuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

## Ministri i Drejtësisë i Maqedonisë viziton Gjilanin

GJILAN, 23 GUSHT - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur të mërkurën në takim punë ministrit të Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, Krenar Lloga.

Kryetari Hyseni e ka falënderuar ministrit Lloga për vizitën, derisa theksoi se ishte një takim përmbajtësor, në të cilin është diskutuar edhe lidhur me bashkëpunimin e komunës së Gjilanit me disa nga komunat e Maqedonisë së Veriut. "Ishte një bashkëbisedim përmbajtësor me temat që lidhen edhe me përvojat nga e kaluara e ministrit në pushtetin lokal dhe për sfidat e ndryshimet që pritet të ndodhin në të mirën e shqiptarëve në

Maqedoninë e Veriut, sikurse edhe për sfidat që paraqiten në Kosovë. Po bëhen tash e gjashtë muaj që ministri e drejton njërin prej ministrive më të ndjeshme në Republikën e Maqedonisë dhe unë i urova shumë suksese në pozitën e re dhe për punën që po e bën", ka thënë kryetari Hyseni. Ndërkaq ministri i Drejtësisë i Maqedonisë së Veriut, Krenar Lloga, e ka falënderuar kryetarin Hyseni për pritjen, duke thënë se kanë diskutuar lidhur me sfidat e pushtetit lokal në të dy vendet. "Kemi sfida që na bëjnë bashkë edhe në sfida rajonale, por edhe ato që i kemi brenda shteteve tona", ka thënë, ndër të tjera, ministri Lloga.



## Vazhdojnë punimet për ndërtimin e stacionit të autobusëve në Podujevë



PODUJEVË, 23 GUSHT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar një takim me zëvendësministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Ali

Tafarshiku, me të cilin i kanë përcjellë punimet e ndërtimit të stacionit të autobusëve në Podujevë. Sipas Bulliqit, projekti i ndërtimit të stacionit po realizohet në

bashkëfinancim në mes të komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. "Ndërtimi i stacionit po zhvillohet sipas planit dinamik. Pritet që në vitin 2024 Podujeva

të bëhet me stacion të ri të autobusëve. Po ashtu, gjatë takimit kemi biseduar edhe për mundësi të tjera bashkëpunimi për projekte të tjera për Podujevën", ka thënë Bulliqi.

## Takohen kryetari i Skenderajt dhe i Zveçanit, diskutojnë për bashkëpunim

SKENDERAJ, 23 GUSHT - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka pritur në zyrën e tij kryetarin e komunës së Zveçanit, Ilir Peci, i cili shoqërohej edhe nga nënkryetari Besart Peci

me bashkëpunëtorë. Në takim është diskutuar për bashkëpunimin mes dy komunave në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave që kanë njësitë administrative komunale. Kryetari Nura

është shprehur i gatshëm ta ofrojë gjithë ndihmën e nevojshme në funksion të fuqizimit të organeve komunale të Zveçanit në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohen shërbime cilësore.



# Shtyhet për dy muaj procesi i regjistrimit të popullsisë në Kosovë

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Qeveria e Kosovës e ka shtyrë për dy muaj procesin e regjistrimit të popullsisë, i cili do të nisë më 1 nëntor të këtij viti.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke e dhënë arsytimin e këtij vendimi gjatë mbledhjes së qeverisë, tha se një sërë vonesash në proces e kanë bërë të pamundur nisjen e regjistrimit të popullsisë më 1 shtator. Ai ka thënë se procesi është shtyrë shkaku i rezistencës nga Komisioni Qendror i Regjistrimit nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. “Edhe pse përgatitjet u bënë përkundër rezistencës së prodhuar edhe brenda Komisionit Qendror të Regjistrimit nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, procesin nuk mund ta fillojmë para datës 1 nëntor. Pra, [procesi do të fillojë] dy muaj më vonë për shkak të pamundësisë së Agjencisë së Statistikave të

Kosovës (ASK) që me vonesat e shkaktuara t’i planifikonte detajet”, ka deklaruar Kurti.

Kurti ka pohuar se në vonimin e procedurave ka ndikuar edhe vendimi i qeverisë për ta trajtuar bashkëpunimin me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) si marrëveshje ndërkombëtare e jo “memorandum bashkëpunimi me një organizatë ndërkombëtare”.

Trajtimi i këtij bashkëpunimi si marrëveshje ndërkombëtare do të thotë që marrëveshja do të duhej të kalonte në Kuvendin e Kosovës me votat e dy të tretave të deputetëve.

Opozita i ka bojkotuar propozimet e tilla që qeveria i ka sjellë në Kuvend. “Qeveritë e kaluara, në vitin 2011, për qëllim të regjistrimit të popullsisë, bashkëpunimin me një organizatë ndërkombëtare të cilës ia transferuan miliona euro për qëllime të prokurimit e bënë me një memorandum të thjeshtë bashkëpunimi. Mënyra



e tillë e bashkëpunimit e cenon shtetësinë e Kosovës. Një gjë e tillë me qeverinë tonë nuk bëhej”, ka thënë Kurti.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është bërë në vitin 2011, ndërsa regjistrimi që është

dashur të bëhet në vitin 2021 është shtyrë për shkak të pandemisë Covid-19.

Sipas regjistrimit të 2011-s, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1.8 milion banorë, por në këtë

regjistrim nuk ishin përfshirë banorët e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës - Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut - pasi që në atë kohë ata kishin refuzuar procesin.

## Inaugurohet në Prishtinë “Muri i nderit”



PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në inaugurimin e “Murit të nderit” nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan dhe Shoqata e Miqësisë Kosovë - Izrael. Të pranishëm ishin edhe Joseph

DioGuardi, kryetar i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, Shirley Cloyes DioGuardi, drejtoreshë ekzekutive e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan, Lekë Rezniciq, Shoqata e Miqësisë Kosovë-Izrael, ambasadori Jeffrey

Hovenier i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Joern Rohde i Republikës Federale të Gjermanisë.

Në ambientet e Parkut të Qytetit në Prishtinë kryeministri Kurti u shpreh i nderuar të jetë pjesëmarrës në ceremoninë e

inaugurimit të këtij muri i cili nderon vetëmohimin dhe sakrificën e shqiptarëve në Kosovë që shpëtuan miqtë dhe fqinjët e tyre hebrej nga e keqja e Holokaustit. “Falë punës së përbashkët të Shoqatës së Miqësisë Kosovë-Izrael dhe

Fondacionit Shqiptaro-Amerikan ne kemi nxjerrë në sipërfaqe këtë pjesë të rëndësishme të historisë së përbashkët të dy popujve tanë. Falë përpjekjeve të tyre emrat e këtyre heronjve do të mbeten përgjithmonë të gdhendur në këtë mur”, u shpreh kryeministri. Ai e cilësoi se “Muri i nderit” jo vetëm që përkujton aktet heroike, por shërben edhe si monument i vlerave të përbashkëta dhe i miqësisë së qëndrueshme të popullit të Kosovës dhe popullit hebre në mbarë botën. Sipas tij, e përbashkëta në mes të këtyre dy popujve qëndron në ndjenjën e privimit nga shtëpia, në kuptimin e plotë të fjalës. “Dhe për të dy popujt ishte themelimi i një shteti - shteti i Izraelit dhe shteti i Kosovës - që më në fund ua dha atyre ndjenjën e fortë të shtëpisë, nga e cila ata ishin privuar më parë”, shtoi kryeministri.

Fjalën e tij kryeministri e përmbylli duke kujtuar se ky “Mur i nderit” i kushtohet jo vetëm historisë, por edhe pasardhësve. “Bindshëm do të shërbejë si një simbol i fuqishëm i miqësisë së përjetshme të popujve tanë - tani dhe për brezat që do të vijnë”, ka thënë Kurti.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se le të mbetet ky “Mur i nderit” një urë miqësie për popullin hebre si në Izrael ashtu edhe në mbarë botën dhe le të qëndrojë si një simbol i përjetshëm i dashurisë sonë për njerëzimin.

## Shkarkohet Bujar Ejupi nga pozita e drejtorit të Autoritetit të Aviacionit Civil

PRISHTINË, 23 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka shkarkuar Bujar Ejupin nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil. Propozim-vendimin për këtë e bëri zëvendësministri i MMPH-së, Hysen Durmishi. "Sot para jush paraqes propozim-vendimin për përfundimin e parakohshëm të mandatit të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, Bujar Ejupi. Mosaprovimi i raporteve

vjetore të AAC nga Kuvendi i Kosovës, raportimi i shkeljeve proporcionale të z. Ejupi nga ana e bordit mbikëqyrës të AAC-së, raportimi me shumë gjetje i autoriteti mbikëqyrës të Islandës në emër të KFRO-it, raporti me 20 gjetje i ekspertëve austriakë të kontraktuar nga DEASA dhe një varg shkeljesh të ndryshme, paraqesin bazë të mjaftueshme për përfundimin e parakohshëm

të mandatit të z. Ejupi", ka thënë Durmishi. Shoqata Sindikale e Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil javë më parë kishte kërkuar shkarkimin e drejtorit Bujar Ejupi. Sindikata e AAC-së kishte kundërshtuar projekt-rregulloren e brendshme të cilën drejtori Ejupi e kishte dërguar në MPB për aprovim, si dhe gjithë procesin që i ka paraprirë këtij dokumenti.



## Falja e 100 eurove të tatimit në pronë, Asociacioni i Komunave pritet ta dërgojë ligjin në Kushtetuese

PRISHTINË, 23 GUSHT - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka paralajmëruar se Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme do të dërgohet në Gjykatë Kushtetuese. Sipas AKK-së, komunat me miratimin e këtij ligji në Kuvendin e Kosovës do të humbasin dhjetëra miliona euro dhe miratimi i tij pa konsulta paraprake me komunat e ka cenuar autonominë lokale financiare. "Duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, ku thuhet se palët e autorizuar për ngritjen e rasteve në gjykatë janë edhe komunat, atëherë Bordi i AKK-së, duke marrë parasysh që komuna si institucion shtetëror është e autorizuar ta kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve ligjore, u rekomandon komunave ta dërgojnë këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese për interpretim kushtetues", ka njoftuar AKK-ja.

Në këtë reagim thuhet se ky ligj ka ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e të hyrave të komunës, afektim në projektet kapitale dhe debalancim në mes të projeksioneve investuese dhe të hyrave vetjake. "AKK-ja edhe në këtë rast ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të ketë debat dhe konsultime me komunat sa i përket këtij projektligji sepse ka të bëjë me autonominë financiare të komunave dhe i cili ligj ka ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetet e tyre, së këndejmi edhe në projektet kapitale sepse tatimi në pronë është e hyrë vetjake e komunave. As



Kuvendi i Kosovës nuk e diskutoi këtë projektligj me komunat dhe me procedura të përshpejtuara e miratoi edhe në lexim të dytë", thuhet në reagim. Më tej thuhet se Ministria e Financave mori vendim që ta

ndryshojë Ligjin mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ku gjatë procesit të amendamentimit nuk i konsultoi komunat e Kosovës. "Kryetarët e Komunave dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) kanë kërkuar nga niveli qendror

që të konsultohet sa i përket amendamentimit të këtij ligji sepse ky ligj i prek në mënyrë të drejtpërdrejtë buxhetet e komunave. Pastaj MFTP-ja e dërgoi për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës këtë projekt ligj pa konsulta me

komunat. Qeveria e miratoi si të tillë dhe e procedoi për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka theksuar AKK-ja. AKK-ja edhe në këtë rast ka kërkuar nga Kuvendi që të ketë debat dhe konsultime me komunat. "Në këtë ligj, në Kapitullin II / Falja e Tatimit në Pronë për vitin tatimor 2023 Neni 11/B, thuhet: Pika 1. Shuma e faljes së Tatimit në Pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së Tatimit në Pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli. Pika 2. Vendimi për faljen e Tatimit në Pronë merret nga Kuvendi i Komunës i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni", thuhet tutje në reagim. Tatimi në Pronë është taksë vjetore komunale dhe përcaktohet nga shumëzimi i vlerës së pronës me normën tatimore. Kjo normë është 0.15 për qind e vlerës së përgjithshme të pronës. Rritja e faturave të tatimit në pronë ka ndodhur pas vlerësimit të përgjithshëm të tokave dhe objekteve rezidenciale që ka bërë MF-ja në fund të vitit të kaluar. Pas këtij vlerësimi, tatimi në pronë për disa është rritur deri në 100 për qind e për disa ka mbetur i pandryshuar, pasi vlera e pronës, pas vlerësimit, nuk ka ndryshuar. Partitë opozitare në Kuvendin e Kosovës e kanë kundërshtuar rritjen e tatimit në pronë. Nga tatimi në pronë buxheti i Kosovës ka të hyra vjetore deri në 40 milionë euro.

## Ndahen 60 mijë euro për mbështetjen e punësimit të grave

PRISHTINË, 23 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka ndarë 60 mijë euro për mbështetjen e punësimit të grave dhe 100 mijë euro të tjera për investime në infra-

strukturë. Ministri i Financave, Hekuran Murati, në arsyetimin e vendimit tha se këto mjete janë në kuadër të zbatimit të

masës 1.3 dhe masës 5 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. "Bëhet fjalë për masën 1.3, që është mbështetja për punësimin e grave, ku

duhet të ndahen 60 mijë euro si dhe masën 5 për investim në infrastrukturë dhe ambient, ku parashihen të ndahen 100 mijë euro", ka thënë Murati.



# U krijua pas zbulimit në 1969. Si funksionon “Fondi i Naftës” i Norvegjisë



Fondi Qeveritar Global i Pensioneve u krijua pasi Norvegjia zbuloi naftë në Detin e Veriut. Fondi u krijua për të mbrojtur ekonominë nga ulje-ngritjet e të ardhurave nga nafta. Ai shërben gjithashtu si një rezervë financiare dhe si një plan kursimi afatgjatë, në mënyrë që brezi aktual dhe i ardhshëm i Norvegjisë të përfitojnë nga pasuria e naftës. Në vitin 1969, një nga vendburimet më të mëdha të naftës në botë në det të hapur u zbulua në Norvegji. Papritur, shteti nordik kishte shumë naftë për të shitur dhe ekonomia e tij u rrit në mënyrë dramatike.

Qysh herët, u vendos se të ardhurat nga nafta dhe gazi duhet të përdoren me kujdes për të shmangur çekuilibrat në ekonomi. Në vitin 1990, parlamenti norvegjez miratoi

legjislacionin për ta mbështetur këtë ide, duke krijuar atë që sot është Fondi Qeveritar Global i Pensioneve, dhe paratë e para u depozituan në fond në vitin 1996. Siç sugjeron emri, u vendos që fondit të investohej vetëm jashtë vendit.

Të ardhurat nga nafta kanë qenë shumë të rëndësishme për Norvegjinë, por një ditë nafta do të mbarojë. Qëllimi i fondit është të sigurojë që ato para të përdoren me përgjegjësi, dhe kështu të mbrohet e ardhmja e ekonomisë norvegjeze.

## Si rritet fondit?

Megjithëse të ardhurat nga prodhimi i naftës dhe gazit transferohen në fond, këto depozita përbëjnë më pak se gjysmën e vlerës së tij. Pjesa më e

madhe është fituar nga investimi në aksione, të ardhura fikse, pasuri të paluajtshme dhe infrastrukturë të energjisë së rinovueshme.

Sot, ai është një nga fondet më të mëdha në botë, duke zotëruar pothuajse 1.5 për qind të të gjitha aksioneve në kompanitë e listuara në bursë botë. Kjo do të thotë se ne Fondi ka aksione në rreth 9,000 kompani në mbarë botën, duke i dhënë të drejtën për një pjesë të vogël të fitimeve të tyre çdo vit.

Përveç kësaj, fondit zotëron qindra ndërtesa në disa nga qytetet kryesore të botës, të cilat gjenerojnë të ardhura nga qiraja. Fondi gjithashtu merr një fluks të qëndrueshëm të ardhurash nga kreditimi për vendet dhe kompanitë e ndryshme. Duke i përhapur gjerësisht investimet, është zvogëluar rreziku i humbjes së parave të fondit.

## Si shpenzohen kursimet

Çdo vit, qeveria norvegjeze mund të shpenzojë vetëm një pjesë të vogël të fondit, por kjo është gjithësesi pothuajse 20 për qind e buxhetit të qeverisë.

Ekziston një konsensus i gjerë politik se si duhet të menaxhohet fondit. Sa më pak të shpenzohet sot, aq më mirë do të jetë Norvegjia në pozicionin për t'u përballur me rëniet ekonomike dhe krizat në të ardhmen.

Tepricat buxhetore kalojnë në fond, ndërsa deficitet mbulohen me para nga fondit. Me fjalë të tjera, autoritetet mund të shpenzojnë më shumë në kohë të vështira dhe më pak në kohë të mira.

Në mënyrë që nga fondit të

përfitojnë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur edhe në të ardhmen, politikanët kanë rënë dakord për një rregull fiskal që siguron që të mos shpenzohet më shumë se të ardhurat e pritshme në fond.

Mesatarisht, qeveria duhet të shpenzojë vetëm ekuivalentin e të ardhurave reale në fond, i cili vlerësohet të jetë rreth 3 për qind në vit. Në këtë mënyrë, të ardhurat nga nafta kalojnë gradualisht në ekonomi. Në të njëjtën kohë, shpenzohet vetëm të ardhurat vjetore të fondit, dhe jo kapitali i tij. Roli i fondit është të sigurojë që pasuria kombëtare të zgjasë për aq kohë sa të jetë e mundur. Investimet e saj kanë një perspektivë jashtëzakonisht afatgjatë, duke i mundësuar të përballojë luhatjet e mëdha në vlerë në afat të shkurtër. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Daja dhe Gripshi: Ballkani do ta përfaqësojnë në mënyrën më të mirë Kosovën



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani sonte (e enjte) në stadiumin "Fadil Vokrri" do të përballlet me skuadrën e Bate Borisov. Kjo ndeshje është mjaftë e rëndësishme për klubin më të suksesshëm në dy vitet e fundit në Kosovë, pasi një rezultat i favorshëm do t'i jepte mundësinë që të përsërit suksesin e vitit të kaluar që të luajë në fazën e grupeve. Në fakt, ndeshja që zhvillohet sonte në Prishtinë i takon "play-off"-it në kuadër të Ligës së Konferencës. Një ditë para ndeshjes në konferencë për medie, trajneri Ilir Daja ka thënë se Ballkani

në këtë ndeshje nuk e përfaqëson vetëm Suharekën, por mbarë Kosovën, prandaj edhe do të japin maksimumin. "Nëse flasim rreth historisë që kemi bërë, për të dytin vit radhazi gjendemi në 'play-off'. Në një moment të tillë, përfaqësimi ynë kalon përtej Ballkanit të Suharekës, pasi përfaqësojmë edhe Kosovën. Ditët e fundit i kam ndarë lojtarët në dy grupe, ata që luajtën në kampionat, në fundjavë, dhe ata që qëndruan pushim. Menjëherë pas konferencës, do të kryejmë dhe seancën e fundit ku do të jemi të gjithë të bashkuar, në prag të këtij takimi, që sigurisht nuk do të përfaqësojmë vetëm Ballkanin e Suharekës", ka thënë Daja, i cili

